



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2

Dhjetor 2024

## **RAPORTIM RASTI: EKSTRAKSIONET DENTARE PËR QËLLIME TË TRAJTIMIT ORTODONTIK**

**Donieta Shabanllari\*, Flavina Vata\*\*, Elma Elezi\*\*\***

*\*Departamenti i Stomatologjisë, Specializimi "Ortognatodonci",  
Albanian University*

*Klinika dentare private "Shabanllari Dental", Tiranë, Shqipëri*

*\*\*Klinike Dentare private "Vata Dent", Tiranë, Shqipëri*

*\*\*\*Klinike dentare private "Klinika Elezi", Tiranë, Shqipëri*

### **Përmbledhje**

Ekstraksioni i dhëmbëve për qëllime ortodontike është një temë shumë e diskutueshme nga profesionistët. Lloji i malokluzionit dhe faktorët individual të pacientit luajnë një rol të rëndësishëm për vendimin për këtë procedurë.

Ky studim paraqet një rast klinik të trajtimit ortodontik përmes ekstraksionit të premolarëve të pare ne maksile dhe premolareve te dyte ne mandibul te një pacient 17-vjeçar me malokluzion të klasës II dhe grumbullime dentare dentare.

Pas analizimit të të dhënave klinike dhe radiologjike, u vendos të kryhej ekstraksioni i premolarëve të pare ne maksile dhe premolareve te dyte ne mandibul për të krijuar hapësirën e nevojshme dhe për të përmirësuar marrëdhëniet skeletore dhe estetike të dhëmbëve gjithashtu përmirësim të este-tikës faciale. Trajtimi zgjati 28 muaj dhe përfshiu vendosjen e braketave metalike për të siguruar rreshtimin e duhur të dhëmbëve.

Rezultatet treguan përmirësime të dukshme, përfshirë uljen e këndit ANB nga 6° në 4°, përmirësimin e estetikës së buzëqeshjes dhe stabilitet më të mirë dentare. Krahasimi i këtij rasti me literaturën ekzistuese konfirmon efektivitetin e ekstraksionit të premolarëve për menaxhimin e malokluzioneve të klasës II dhe grumbullimeve dentare vacanërisht në rastet hiperdivergjente.

Monitorimi i vazhdueshëm dhe përdorimi i retainers fiks në nofullën e poshtme dhe të lëvizshme në maksilë mbetet thelbësore gjatë fazës retentive.

**Fjalë çelës:** ekstraksion i premolarve, stabiliteti estetik dhe funksional, ortodonci, malokluzioni i klases II skeletike, hiperdivergjente.

## CASE REPORT: DENTAL EXTRACTIONS FOR ORTHODONTIC TREATMENT PURPOSES

### Abstract

Extraction of teeth for orthodontic purposes is a highly controversial topic by professionals. The type of malocclusion and individual factors of the patient play an important role in deciding this procedure.

This study presents a clinical case of orthodontic treatment through the extraction of first-in-class premolars and second premolars in mandibles in a 17-year-old patient with Grade II malocclusion and dental hoses.

After analyzing clinical and radiological data, it was decided to perform the extraction of the first premolars in the maxile and the second premolars in the mandibule to create the necessary space and to improve the skeletal and aesthetic relationship of the teeth as well as improve facial aesthetics. The treatment lasted 28 months and involved the insertion of metal braces to ensure proper alignment of teeth. The results showed significant improvements, including lowering the ANB angle from 6° to 4°, improving smile aesthetics and better dental stability. The comparison of this case with existing literature confirms the effectiveness of premolar extraction for the management of Grade II malocclusions and dental collections in particular in hyperdivergent cases. Continuous monitoring and use of fixed retainers in the lower and mobile jaw on the max remains essential during the retentive phase.

**Keywords:** *premolar extraction, aesthetic and functional stability, orthodontics, malocclusion of the skeletal II class, hyperdivergent.*

### Hyrje

Ekstraksion i dhëmbëve të shëndetshëm për qëllime ortodontike vazhdon të mbetet një çështje e diskutueshme nga profesionistët. Është një nga strategjitë më të përhapura për të krijuar hapësirë në harkun dentar. [1] Ekstraksioni për trajtimin ortodontik nuk është ide e re. Calvin Case theksoi përdorimin e ekstraksionit në ortodonci në librin e tij të vitit 1771 “Historia natyrore e dhëmbëve”. Lloji i malokluzionit dhe mosha e pacientit mund të jenë faktorë të rëndësishëm në vlerësimin nëse duhet kryer ekstraksioni. [1]

Është e rëndësishme të merret parasysh pacienti në tërësi në planifikimin e trajtimit. Historia mjekësore, qëndrimi ndaj trajtimit, higjiena orale, shkalla e kariesit dhe cilësia e dhëmbëve është e rëndësishme. [2] Gjithashtu duhet të vlerësohet stabiliteti i efektit të ndërhyrjes.

Janë disa rrethana që indikojnë ekstraksionin e dhëmbit në trajtimin ortodontik: madhësia e dhëmbit e madhe në raport me madhësinë e harkut, hipodontia (nëse vendoset të mbyllet hapësira, mund të mos ketë nevojë për ekstraksion), kariesi, malokluzion, dhëmbë të impaktuar, trajtim ortodontik kamufllazh, korrigjim i segmentit bukal, dhëmbë të keqformuar, dhëmbë të përfshirë periodontalisht, kirurgji ortognatike, çarje e buzës dhe qiellzës.[3]

Cilësia dhe prognoza e dhëmbëve duhet merren parasysh me kujdes, pasi kjo mund të anashkalojë faktorë të tjerë. Dhëmbët hipoplastike, shumë të restauruar ose me karies në përgjithësi duhet të hiqen në preferenca ndaj dhëmbëve të shëndetshëm. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në segmentet labiale ku estetika është e vështirë për t’u mbajtur me humbjen e një incizivi ose kanini. Dhëmbët e formës ose madhësisë jonormale mund të konsiderohen për heqje pasi mund të duken të shëmtuar dhe të jetë e vështirë për t’u rreshtuar estetikisht. [4,5]

Planifikimi i trajtimit ortodontik është i rëndësishëm për zgjidhjen e një malokluzioni dhe ortodonti duhet të marrë një vendim pas analizave të kujdesshme. Në rastet kufitare, zgjedhja e dhëmbëve që do të ekstrahohen përcaktohet nga shkalla e mospërputhjes dhe lëvizja e dhëmbëve që kërkohet gjatë trajtimit. [6,7,8,9]

### **Qëllimi i studimit**

Qëllimi i këtij studimi është të paraqesë me anë të një raport rasti optimizimin e trajtimit ortodontik me ekstraksionin e premolarëve të parë në maksilë dhe premolarëve të dytë në mandibul.

### **Materiale edhe Metoda**

Një pacient 17 vjec, mashkull u paraqit pranë klinikës dentare “Shabanllari Dental” me ankesën kryesore të grumbullime dentare në maksilë dhe mandibul dhe vendosje dentare jo estetike të dhëmbëve. Për vlerësimin e rastit u krye ekzaminimi klinik i pacientit. Gjithashtu ekzaminim radiografik me anë të radiografisë paronamike dhe cephalometrike. Gjatë fazave të ndryshme trajtimi u dokumentua me anë të fotove intra dhe eksta orale.

Protokolli i trajtimit përfshiu tre faza:

Faza I ekstraksionin e premolarëve të parë në maksilë edhe premolarët e dytë në mandibul .

Faza II braketave metalike për një periudhë 28 muaj.

Faza III përdorimi i retainers fiks në nofullën e poshtme dhe të lëvizshme në maksilë.

Fokusi kryesor gjatë trajtimit ishin këto objektiva: përmirësimi i estetikës faciale, ruajtja e vertikalitetit dhe planit të okluzionit si celsi kryesor i trajtimit, rregullimi edhe drejtimi i dhëmbëve edhe arritja e një klase të I molare edhe kanine. Pacientit u sugjerua terapia me një logoped sepse ai ka nje gëlltitje atipike.

Për trajtimin dhe raportimin e rastit është marrë pëlqimi i informuar.